



Pratje	10/2024	Vlera Vrednost
02-016/01		1175

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënjën në shfrytëzim dher këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 5, Rregullores QRK Nr.9/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës komunale të Qeverisë së Kosovës, në bazë të Vendimit paraprak për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik me nr.01-110/05-833 të datës 31.05.2024, lidhur me Vendimin për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënjën e pronës së paluajtshme të komunës tek shtëpia e Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatshkurtur prej 13 viteve nr.01-110/05-834 të datës 31.05.2024 në harmoni të plotë me Vendimit për plotësimin e vendimit nr. 01-110/05-834 te dates 31.05.2024 për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatim të procedurave për dhënjën e pronës paluajtshme të Komunës tek shtëpia e kultures "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatshkurt prej 13 viteve, procesverbalit të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënjes ne shfrytezim të pronës së paluajtshme të komunës me datën 07.10.2024 , Komuna e Vitisë shpall:

NJOFTIM PUBLIK Nr.1/2024

Ankand për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtër prej 13 (trembëdhjetë) viteve të pronës komunale:

1.Parcela kadastrale P-701010007-02591-0 me spërfaqe prej 16 m² në zonën kadastrale Viti, pronë e Komunës së Vitisë e destinuar të jepet në shfrytëzim për kjoskë.
Të drejtë pjesëmarrje në ankand kanë personat fizik dhe juridik

Dëshmitë e kërkuara:

- 1.Çertifikatën e rexhistrimit të biznesit-Numrit unik identifikues (NUI)
- 2.Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale
- 3.Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (për përsôn juridik).
4. Ofertat (një origjinal dhe një fotokopje) me përshkrimin e ankandit duhet të futen në zarf të mbyllur, protokooohen ne protokolin e komunës dhe dorëzohen në afatin ligjor.

Kriteret për fituesin

-Oferta e përgjegjshme me çmimin ma të lartë: Çmimi minimal në bazë mujore është 45 euro

Ndalohet bartja e shfrytëzimit të paluajtshmerisë se komunës në personin e tretë, ku me rastin e përfundimit të afatit të shfrytëzimit, prona i kthehet pronarit përkatësisht Komunës së Vitisë në shfrytëzim.

Ofertat mund të tërhiqen në formë fizike , Vetëm ofertat e kompletuara me dokumentet e kërkuara do të merren parasysh.

Hapjen dhe vlerësimin e ofrtave do ta bëjë Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave të ankandit është deri më **25.10.2024**, Salla tek Objekti i Kryetarit , kati i parë, Afati i dorëzimit të ofertave me **28.10.2024** deri në ora **13.30**, salla tek objekti i kryetarit, Komuna e Vitisë. Hapja e ofertave bëhet më **28.10.2022** në ora **14:00** në sallën tek objekti i kryetarit kati parë, Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni i emëruar i Kuvendit të komunës, në afat prej 3 ditëve. Personi kontaktues: **haxhiu@hotmail.com** ose në tel. 044 718 094.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pranë Komisioni të ankesave për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale.

Kryesuesi i Komisionit:
Albulena Haxhiu

